FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.29 3 prill 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MASH nr. 4, datë 29.2.2012	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit" ..	1377
Udhëzim i MASH nr. 5, datë 6.3.2012	Për një shtesë në udhëzimin nr. 5, datë 18.2.2009 "Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar……	1379
Udhëzim i MPÇSSHB nr. 2, datë 8.3.2012	Për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të mbrojtjes sociale për vitin 2012……	1379
Vendim i BSH nr. 14, datë 29.2.2012	Për dhënien e miratimit të shndërrimit të degës së Bankës Alpha - Albania në filial/bankë vendase……	1381
Vendim i BSH nr. 15, datë 29.2.2012	Për dhënien e miratimit të shndërrimit të degës së Bankës Kombëtare të Greqisë, Tiranë në filial/bankë vendase……	1382
Vendim i ERE nr. 22, datë 24.2.2012	Për miratimin e rregullores së lidhjeve të reja, marrëveshjes së lidhjes së re dhe formularit të aplikimit për lidhje të re….	1382
Vendim i ERE nr. 24, datë 2.3.2012	Për licencimin e shoqërisë "Peshku Picar 1" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Picari 1"……	1405
Vendim i ERE nr. 25, datë 2.3.2012	Për licencimin e shoqërisë "Hydro Salillari" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektirike nga hec "Vertop"……	1406
Vendim i ERE nr. 26, datë 2.3.2012	Për licencimin e shoqërisë "Hydro Salillari" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike……	1407
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Artur Madhi……	1407
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lefter Hoxha…	1407

UDHËZIM
Nr. 4, datë 29.2.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 45, DATË 19.12.2011 "PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të pikës 3 të nenit 58 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"2. Studentët e marrin numrin e matrikullimit (NIM) të përbërë nga tri germa dhe tri shifrat të kodit të regjistrit dhe gjashtë shifrat e numrit të studentit në regjistrin përkatës. Formimi i numrit të matrikullimit është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi".

2. Pika 5 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"5. Çdo regjistër të ketë një kod të vetin, unikal në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, i përbërë nga tri germa dhe tri shifra. Germa e gjashtë e kodit të regjistrit përcaktohet në bazë të ciklit të studimit dhe formës së studimit sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi".

3. Shtojcat nr. 2 dhe nr. 3 që i bashkëlidheshin udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit" zëvendësohet me shtojcën nr. 2 dhe shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Shtojca nr.1: Formulimi i numrit të matrikullimit



Kodi i IAL përbëhet nga dy germa, të cilat vendosen në mënyrë unike.

Programi i studimit përbëhet nga tri germa.

Tipi i regjistrit do të varet nga cikli dhe forma e studimit. Ai do të jetë i njësuar për të gjitha IAL-të: një cikël studimi+ një formë studimi do të përdorë të njëjtën germë.

Këto tri germat dhe tri shifrat përbëjnë kodin e regjistrimit dhe përcaktohen nga AKP.

Shtojca nr. 3: PASQYRA E STUDENTEVE TE REGJISTRUAR NE VITIN AKADEMIK 2011-2012

Emërtimi sipas ciklit dhe formës së studimit (sipas shtojcës nr. 2)

Nr	Universiteti	Fakulteti	Cikli i studimit	Forma e studimit	Programi i studimit[1]	Data e regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Vendlindja	Numri personal i identitetit[2]	Lloji i Dokumentit të identitetit	Emri i shkollës së mesme/ Universiteti nga vjen[3]	ID e maturës[4]
1																
2																
3																
4																
5																
6																
7																
8																
9																
10																
11																
12																
13																
14																
15																

[1] Të shënohet emërtimi zyrtar i miratuar për programin e studimit.

[2] Numri personal i identitetit në letërnjoftimin ID ose në pasaportën biometrike (ose dokument të barazvlefshëm me të për studentët e huaj).

[3] Të shënohet emri i shkollës së mesme ose universitetit me ciklin përkatës që studenti ka përfunduar dhe përdorur për tu regjistruar.

[4] ID e maturës nëse ka përfunduar shkollën e mesme pas vitit 2006 ose numri i amzës të dëftesës së shkollës së mesme përpara vitit 2006.

Te Universiteti te shënohet emërtimi i plotë zyrtar i Institucionit.
Te Fakulteti të shënohet emërtimi i plotë zyrtar i fakultetit që studenti ndjek.
Te cikli i studimit të shënohet emërtimi i plotë zyrtar.

UDHËZIM
Nr. 5, datë 6.3.2012

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 18.2.2009 "PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 31, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pas shkronjës "m" të pikës 4 të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe shkencës nr. 5, datë 18.2.2009 "Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, të shtohet shkronja "n", si më poshtë:

"n) datën e regjistrimit të studentit në institucionin që lëshon diplomën."

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Jopublik dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 2, datë 8.3.2012

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E SHPËRNDARJES SË FONDIT TË MBROJTJES SOCIALE PËR VITIN 2012

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"(të ndryshuar), ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", si dhe pikës 19/"c", "d" të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2/1, datë 15.2.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012",

UDHËZOJ:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për vitin 2012, fondet e akorduara në programin "Mbrojtja sociale", si transfertë e kushtëzuar, i shpërndan në mënyrë periodike, për:

a) pagesën e dëmshpërblimit e të dënuarve politikë, e cila do të shpërndahet me paraqitjen nga Ministri i Financave të autorizimit për transferimin e "Fondit për dëmshpërblimin e të dënuarve politikë".

b) Pagesën për programin e ndihmës ekonomike.

c) Pagesën për programin e personave me aftësi të kufizuar.

d) Financimin e bashkive për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qendrave të përkujdesit shoqëror të transferuara në njësitë e qeverisjes vendore që u shërbejnë individëve, me qëllim sigurimin dhe ofrimin e standardeve. Financimi bëhet me paraqitjen e projekteve dhe nivelin e financimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore.

2. Për vlerësimin e projekteve të paraqitura dhe nivelin e financimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, krijohet një komision me 8 anëtarë. Komisioni kryesohet nga Ministri dhe anëtarët janë: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Kabinetit të Ministrit, Drejtori i Përgjithshëm i Politikave, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse (si nëpunës zbatues), Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Shërbimeve Sociale, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit, Analizës dhe Statistikës dhe një përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Komisioni mblidhet periodikisht dhe vlerëson projektet e paraqitura që vijnë nga ana e njësisë së qeverisjes vendore, dhe vendos nivelin e financimit.

4. Njësitë e qeverisjes vendore paraqesin projektet dhe nivelin e financimit për financimin nga fondet e mbrojtjes sociale, sipas germës "d" të pikës 1, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social.

5. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore të përcaktojnë kontributin e tyre sipas mundësive financiare.

6 Njësitë e qeverisjes vendore, për mbështetje financiare sipas germës "d" të pikës 1 paraqesin një informacion mbi gjendjen aktuale të ambienteve të qendrave të përkujdesit shoqëror të transferuara në këto njësi, për të cilën kanë paraqitur projekt.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror bën vlerësimin e dokumentacionit dhe kërkesave të paraqitura nga njësia e qeverisjes vendore sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, vlerëson prioritetin e projektit, si dhe nivelin e financimit. Vlerësimi të bëhet pas verifikimit mbi gjendjen aktuale të ambienteve të qendrave të përkujdesit shoqëror.

8. Nëse projekti dhe kërkesa e paraqitur nga njësia e qeverisjes vendore është i plotë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror bën vlerësimin e nivelit të financimit dhe të gjendjes aktuale të ambienteve me qëllim sigurimin dhe ofrimin e standardeve në qendrat e përkujdesit shoqëror.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, vlerësimin e bërë me shkrim sipas pikës 6 dhe 7 të këtij udhëzimi, së bashku me projektin dhe kërkesën e paraqitur nga njësitë e qeverisjes vendore për financimin e mirëmbajtjes së ambienteve të qendrave të përkujdesit shoqëror, i përcjell në MPÇSSHB.

10. Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale, dosjen e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, sipas pikës 4 dhe 7 të këtij udhëzimi e verifikon plotësimin e saj dhe e përcjell në komisionin e ngritur sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, duke informuar me shkrim për çdo projekt, që do të financohet.

11. Komisioni, me marrjen e informacionit nga Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale përcakton vlerën përfundimtare të financimit.

12. Komisioni për përcaktimin e financimit të mirëmbajtjes së ambienteve të qendrave të përkujdesit social do të marrë në konsideratë edhe orientimet e Avokatit të Popullit, si dhe sugjerimet e subjekteve jopublike, të specializuara në këto shërbime.

13. Fondi i miratuar nga Komisioni për mbështetje, sipas germave "d" të pikës 1 të këtij udhëzimi, delegohet si transfertë e kushtëzuar në njësitë e qeverisjes vendore nga MPÇSSHB, së bashku me një kopje të vendimit të Komisionit.

14. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtë të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të këtij fondi.

15. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre fondeve, sipas legjislacionit në fuqi.

16. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore merr vendim për përdorimin e këtij fondi, për qëllimin që është dhënë, së bashku me kontributin e saj.

17. Për raportimin e realizimit të përdorimit të fondit, si dhe kontrollin e përdorimit të tyre të ndiqet e njëjta procedurë si veprohet për fondet buxhetore në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2/1, datë 15. 2.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

VENDIM
Nr. 14, datë 29.2.2012

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË SHNDËRRIMIT TË DEGËS SË BANKËS ALPHA - ALBANIA NË FILIAL/BANKË VENDASE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe të nenit 43 shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 29/1, nenit 29/2 dhe nenit 29/3 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e shndërrimit të degës së "Bankës Alpha-Albania", në filial/bankë vendase të zotëruar 100 % nga Alpha Bank A.E. Greqi.

2. Miratimin e emrit të bankës "Banka Alpha Albania" sh.a.

3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për nënshkrimin e formatit të ri të licencës dhe aneksit të saj për "Banka Alpha Albania" sh.a., pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, si dhe për verifikimin e plotësimit të kushteve të mëtejshme ligjore dhe/ose nënligjore nga banka.

5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr. 15, datë 29.2.2012

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË SHNDËRRIMIT TË DEGËS SË BANKËS KOMBËTARE TË GREQISË, TIRANË NË FILIAL/BANKË VENDASE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe të nenit 43 shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 29/1, nenit 29/2 dhe nenit 29/3 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e shndërrimit të degës së Bankës Kombëtare të Greqisë Tiranë, në filial/bankë vendase, kapitali i së cilës të zotërohet në masën 100% nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A. Greqi.
2. Miratimin e emrit të bankës "Banka NBG Albania" sh.a.
3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për nënshkrimin e formatit të ri të licencës dhe aneksit të licencës për "Banka NBG Albania" sh.a., pas regjistrimit të bankës në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, si dhe për verifikimin e plotësimit të kushteve të mëtejshme ligjore dhe/ose nënligjore nga banka.
5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr. 22, datë 24.2.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË LIDHJEVE TË REJA, MARRËVESHJES SË LIDHJES SË RE DHE FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR LIDHJE TË RE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "g" dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës IV të Kodit të Shpërndarjes, të miratuar me vendimin nr. 100, datë 26.8.2008 të Bordit të Komisionerëve, si dhe pikës 7.1.5 dhe 12 të Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifës së Shpërndarjes, të miratuar me vendimin nr. 79, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.2.2012, pasi shqyrtoi draftin e Rregullores së Lidhjeve të Reja, Marrëveshjes së lidhjes së re dhe formularin e aplikimit për lidhje të re,

VENDOSI:

1. Miratimin e "Rregullores së lidhjeve të reja", marrëveshjes së lidhjes së re dhe formularin e aplikimit për lidhje të re (aktet bashkëlidhur).

2. Shfuqizimin e vendimit të Këshillit Drejtues të ERE-s nr. 17, datë 19.12.2001 "Për miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

RREGULLORE
PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

PJESA I: KËRKESA TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes, të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në sistemin e shpërndarjes, si dhe të përcaktojë procedurat, afatet dhe tarifat për kryerjen e këtij shërbimi nga ana e operatorit të sistemit të shpërndarjes.

1.2 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet bazuar në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Kodit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr. 100, datë 26.8.2008 të Bordit të Komisionerëve, si dhe "Metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike", të miratuar me vendimin nr. 79, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

1.3 Garantimi i lidhjes në rrjetin e shpërndarjes

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, OSSH do të sigurojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes së të gjitha palëve të interesuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

1.4 Personat që kanë të drejtë të aplikojnë

Aplikimi për lidhje të re në sistemin e shpërndarjes mund të kryhet nga:

a) përdoruesit ekzistues të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në sistemin e shpërndarjes (përdoruesi).

b) Çdo person fizik apo juridik, i cili aplikon për realizimin e një lidhjeje të re në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike (aplikanti).

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të pranojë kërkesën për lidhje të re nëse përdoruesi apo aplikanti rezulton debitor dhe nuk ka shlyer detyrimet e mëparshme ndaj operatori i sistemit të shpërndarjes.

1.5 Kërkesa për lidhje të re

Kërkesa për lidhje të re paraqitet pranë zyrave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për:

a) lidhje të objekteve (banimi apo biznesi) me sistemin e shpërndarjes;

b) rritjen e fuqisë së lidhjes ekzistuese;

c) kërkesë për lidhje të përkohshme;

d) lidhje në sistemin e shpërndarjes së burimeve gjeneruese.

1.6 Kriteret për vlerësimin e lidhjes së re apo modifikimin e lidhjes ekzistuese

Operatori i sistemit të shpërndarjes për vlerësimin e një aplikimi për lidhje të re apo modifikim të një lidhjeje ekzistuese do të respektojë kushtet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Shpërndarjes, si dhe kriteret si vijon:

a) Për caktimin e pikës së lidhjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të marrë parasysh vendndodhjen e objektit, për të cilin kërkohet lidhja, afërsia e tij me sistemin e shpërndarjes, nivelin

e sigurisë së furnizimit, nivelin e rrymës së lidhjes së shkurtër, si dhe të gjitha aplikimet tjera për lidhje në të njëjtën pikë të rrjetit të shpërndarjes së Operatori të Sistemit të Shpërndarjes.

b) Lidhjet e reja apo modifikimet e lidhjes ekzistuese nuk duhet të shkaktojnë efekte negative mbi klientët apo përdoruesit ekzistues, dhe as nuk duhet të ndikohen nga efektet negative të klientëve apo përdoruesit ekzistues.

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përcaktojë kushtet e mënyrës së realizimit të lidhjes dhe parametrat teknikë të pajisjeve që do të shërbejnë për lidhjen e konsumatorëve të rinj me sistemin e shpërndarjes konform standardeve europiane dhe standardeve të vetë kompanisë.

1.7 Lejimi për hyrjen në objekt

Përdoruesit apo aplikantët që paraqesin kërkesën për lidhje të re kanë detyrimin që t'i sigurojnë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të drejtën për të hyrë në objektet e tyre, duke i krijuar lehtësira të nevojshme, në mënyrë që ky i fundit të arrijë të vlerësojë të gjitha kërkesat dhe kushtet për lidhjen e re.

1.8 Kërkesat teknike për një lidhje të re

Të gjitha punimet me karakter ndërtimor, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe pajisjet kryesore të kabinave elektrike (çelat hyrëse/dalëse, çelat e transformatorëve, transformatorët e fuqisë, panelet e shpërndarjes së tensionit të ulët, kabllot lidhëse me rrjetin e tensionit të mesëm dhe të ulët, etj.) do të projektohen, prodhohen, instalohen dhe testohen në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore në fuqi dhe do të jenë konform standardeve teknike të cilat janë pjesë e marrëveshjes së lidhjes së re.

1.9 Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike

a) Përdoruesi apo aplikanti është përgjegjës për instalimin e të gjitha pajisjeve mbrojtëse nga lidhja e shkurtër, ato të mbrojtjes nga lidhja me tokën, si edhe pajisjet e mbrojtjes nga mbitensionet (atmosferike, ato të komutimit dhe ato të mbrojtjes nga këputja e përcjellësit të neutralit) për çdo konsumator që do të furnizohet me energji elektrike nëpërmjet lidhjes së re që kërkohet të realizohet.

b) Përdoruesi apo aplikanti duhet të realizojë sistemin e tokëzimit të objektit dhe konsumatorëve të tjerë që furnizohen me energji elektrike nga kjo lidhje e re, në përputhje me kushtet teknike dhe normat në fuqi.

c) Përdoruesi apo aplikanti duhet të garantojë se të gjitha instalimet elektrike në të gjithë objektin që kërkohet të furnizohet me energji elektrike janë kryer, inspektuar dhe provuar nga një subjekt i pajisur me licencë për projektimin dhe instalimin e pajisjeve elektrike në përputhje me rregullat dhe kushtet teknike në fuqi.

d) Përdoruesi apo aplikanti do të marrë përsipër të çlirojë nga çdo lloj përgjegjësie Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për çdo lloj detyrimi që lidhet me dëmtime të çdo lloji të rrjetit shpërndarës të shkaktuara prej instalimeve të brendshme të pajisjeve elektrike në objektin që kërkohet të lidhet me energji elektrike.

1.10 Mënyra e komunikimit

Si formë e përgjithshme komunikimi do të jetë ajo me shkresë zyrtare e shoqëruar me numrin respektiv të protokollit. Gjatë hapave të ndryshëm të zbatimit të procedurave mund të pranohet edhe komunikimi me e-mail midis palëve për efekt të shkëmbimit vetëm të njoftimeve për përfundimin e disa hapave konkretë sikurse janë të përcaktuar në këtë rregullore.

1.11 Mënyra e aplikimit

1. Aplikimi për lidhjen e re do të bëhet sipas formularit tip të aplikimit dhe do të kryhet:

a) Për fuqi të instaluar nga 0-20 kW, pranë zyrave të Kujdesit të Klientit te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e banimit të aplikantit;

b) Për fuqi të instaluar nga 21 deri në 50 kW:

i) Për lidhjet në TU, pranë zyrave të Kujdesit të Klientit te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e banimit të aplikantit;

ii) Për lidhjet në TM, pranë zyrës së Kujdesit të Klientit te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në Tiranë.

c) Për fuqi të instaluar më shumë se 50 kW do të bëhet pranë zyrave të Kujdesit të Klientit te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në Tiranë.

2. Detajet e vendndodhjes së zyrave të Kujdesit ndaj Klientit, si dhe informacion mbi formularin tip që do përdoret për të aplikuar për lidhje të re, si edhe dokumentacionin e plotë që lidhet me kërkesat dhe kushtet teknike që duhet të respektohen për të projektuar dhe realizuar lidhjen e re, në çdo rreth mund të gjenden në adresën përkatëse të internetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

1.12 Kërkesa për furnizim me energji elektrike nga dy burime të pavarura

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të vlerësojë kërkesën për lidhje të re me energji elektrike të objektit nga dy burime të pavarura të energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e shfrytëzimit dhe operimit të sistemit të shpërndarjes. Tarifat respektive për këto raste paraqiten në pjesën e III: "Tarifat".

PJESA II: PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR NJË LIDHJE TË RE

2.1 Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të ulët për fuqi të instaluar 0 - 20 kW.

a) Për rastet kur fuqia e instaluar e kërkuar nga aplikanti për një lidhje të re ose për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, është 0-20 kW, nuk kërkohet të nënshkruhet paraprakisht "Marrëveshje për lidhjen e re".

b) Afati i realizimit të lidhjes së re për këto raste do të jetë:

1. jo më shumë së 5 ditë pune për fuqi të instaluar deri në 10 kw;

2. jo më shumë së 10 ditë pune për fuqi të instaluar 10-20 kw.

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe do të kryejë miratimin e pikës dhe mënyrës së lidhjes në rrjet.

d) Nëse realizimi i lidhjes së re kërkon më shumë së 50 ml kabllo koaksial apo pajisje të tjera (shtylla, punime civile etj.) atëherë aplikanti është përgjegjës për realizimin e punimeve shtesë, si dhe shlyerjen paraprake të detyrimeve për gjatësinë shtesë të kabllos koaksial më shumë së 50 ml.

e) Pas kryerjes nga aplikanti të punimeve shtesë dhe pagesës së tarifës së lidhjes së re, së bashku me shpenzimet e tjera, përgatitet urdhri për vendosjen e aparatit matës (boks individual me matës, përfshi 50 ml kabllo koaksial dhe elektrodë tokëzimi). Sistemi i matjes së energjisë duhet të instalohet brenda 2 ditëve punë nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes dhe do të kryhet në prezencë të subjektit të autorizuar sikurse përcaktuar nga ligji i sektorit për energjinë elektrike. Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet në të njëjtën kohë me vendosjen e aparatit matës.

f) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron lidhjen e re ose modifikimin e kryer për aplikantin/klientin apo përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij, së bashku me kontratën e furnizimit me energji elektrike brenda 3 ditëve punë pas vënies në tension. Operatori i sistemit vë në dispozicion të subjektit të autorizuar informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.

2.2 Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese kur fuqia e instaluar është 21-50 kW.

a) Për rastet kur fuqia e instaluar për një lidhje të re ose për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese është 21- 50 kW, në tension të ulët, procedurat dhe afatet kohore do të jenë ato të përcaktuara në pikën 2.1

b) Për rastet kur fuqia e instaluar për një lidhje të re ose për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, është 21- 50 kW, në tensionin e mesëm duhen të plotësohen procedurat dhe afatet, si më poshtë:

1. Përdoruesi apo aplikanti duhet të ketë miratuar paraprakisht nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT) projektin elektrik të objektit për të cilin kërkohet lidhja e re për furnizim me energji elektrike.

2. Për rastet kur nuk parashikohet ndërtimi i kabinës së re elektrike, atëherë nuk do kërkohet të nënshkruhet paraprakisht "Marrëveshje për lidhjen e re".

3. Periudha e realizimit të lidhjes së re për këto raste do të jetë jo më shumë së 15 ditë punë prej ditës së depozitimit të aplikimit.

4. Nëse realizimi i lidhjes së re kërkon më shumë së 50 ml kabllo (koaksial ose kabllo PVC, sikurse parashikohet në miratimin e pikës së lidhjes) apo pajisje të tjera (shtylla, punime civile etj.) atëherë përdoruesi apo aplikanti është përgjegjës për realizimin e punimeve shtesë, si dhe shlyerjen paraprake të detyrimeve për gjatësinë shtesë të kabllos më shumë së 50 ml.

5. Pas kryerjes nga aplikanti të punimeve shtesë, si dhe kryerjen e pagesës së tarifës së lidhjes dhe shlyerjes së detyrimeve të tjera, përgatitet urdhri për vendosjen e aparatit matës (boks individual me matës përfshi 50 ml kabllo koaksial dhe elektrodë tokëzimi). Sistemit i matjes së energjisë duhet të instalohet brenda 2 ditëve punë nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes dhe do të kryhet në prezencë të subjektit të autorizuar sikurse përcaktuar nga ligji për sektorin e energjisë elektrike. Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet në të njëjtën kohë me vendosjen e aparatit matës.

6. Në rast se gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen (të instaluara nga aplikanti), atëherë aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jofunksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.

7. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron përdoruesin apo aplikantin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij/tyre së bashku me kontratën e furnizimit me energji elektrike brenda 2 ditëve punë, pas vënies në tension Operatori i Sistemit vë në dispozicion të subjektit të autorizuar informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.

2.3 Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të mesëm kur fuqia e instaluar është mbi 50 kW.

1. Përdoruesi apo aplikanti duhet të ketë miratuar paraprakisht nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT) projektin elektrik të objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike. Ky projekt duhet të ketë/të pasqyrojë të gjitha detajet konstruktive dhe mënyrën e realizimit të instalimeve të brendshme të tij, duke u shoqëruar me relacionin teknik përkatës për të treguar të gjitha ngarkesat elektrike dhe mënyrën e vendosjes së tyre brenda objektit.

2. Për rastet kur parashikohet ndërtimi i kabinës së re elektrike, atëherë do kërkohet të nënshkruhet paraprakisht "Marrëveshje për lidhjen e re".

3. Periudha e vlerësimit prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të kërkesës së bërë nga përdoruesi apo aplikanti dhe paraqitja për pranim dhe nënshkrim i propozimit për lidhjen dhe "Marrëveshjes së lidhjes së re" nuk do të jetë jo më shumë së 20 ditë punë prej ditës së paraqitjes së aplikimit.

4. Përdoruesi apo aplikanti do të paraqesë projektin elektrik të kabinës elektrike dhe mënyrën e lidhjes së saj në rrjetin elektrik pas nënshkrimit të Marrëveshjes së lidhjes së re, nëpërmjet lejes për fillimin e projektimit që do të nxirret nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga përdoruesi apo aplikanti dhe nëse aplikimi nuk është i plotë, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë përdoruesin apo aplikantin me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data kur aplikimi është dorëzuar për vlerësim.

6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe, në varësi të gjendjes së rrjetit elektrik në atë zonë, do të përgatisë mënyrën e lidhjes së objektit në rrjet. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë propozimin dhe marrëveshjen për lidhjen e re dhe do t'ia dërgojë aplikantit për pranim sipas afateve të pikës 2.3."c".

7. Propozimi për lidhjen e re i përgatitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të pranohet nga aplikanti jo më vonë se pesë (5) ditë punë nga data që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes e ka vendosur propozimin e tij në dispozicion të aplikantit.

8. Nëse në propozim është parashikuar që lidhja e re të kryhet në tensionin e ulët dhe aplikanti e pranon propozimin, atëherë aplikanti duhet të paguajë detyrimet përkatëse brenda 5 ditëve punë nga njoftimi i propozimit të bërë, përndryshe propozimi bëhet i pavlefshëm dhe ai duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re:

a) Nëse realizimi i lidhjes së re kërkon më shumë së 50 ml kabllo (koaksial ose kabllo PVC, sikurse parashikohet në miratimin e pikës së lidhjes) apo pajisje të tjera (shtylla, punime civile etj.), atëherë aplikanti është përgjegjës për realizimin e punimeve shtesë, si dhe shlyerjen paraprake të detyrimeve për gjatësinë shtesë të kabllos më shumë së 50 ml.

b) Pas kryerjes nga aplikanti të punimeve shtesë, si dhe kryerjen e pagesës së tarifës së lidhjes dhe shlyerjes së detyrimeve të tjera, përgatitet urdhri për vendosjen e aparatit matës (boks individual me matës përfshi 50 ml kabllo koaksial dhe elektrodë tokëzimi). Sistemit i matjes së energjisë duhet të instalohet brenda 2 ditëve punë nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes. Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet në të njëjtën kohë me vendosjen e aparatit matës.

c) Në rast se gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen (të instaluara nga aplikanti), atëherë aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jofunksionale, deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.

d) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron aplikantin/klientin apo përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij, së bashku me kontratën e furnizimit me energji elektrike brenda 2 ditëve punë pas vënies në tension.

9. Nëse në propozimin dhe marrëveshjen e lidhjes së re është parashikuar lidhja e energjisë në tensionin e mesëm dhe aplikanti pranon propozimin, atëherë aplikanti dorëzon te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes formularin e pranimit të propozimit dhe marrëveshjen e lidhjes së re të nënshkruar. Brenda 2 ditëve të punës nga kryerja e pagesës, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë urdhrin administrativ për fillimin e projektit në përputhje me kërkesat dhe kushtet teknike të paraqitura në marrëveshjen e lidhjes.

a) Pas dorëzimit të projektit të detajuar, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet ta analizojë atë, dhe nëse projekti është në përputhje me kushtet teknike, brenda 2 ditëve punë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të miratojë projektin dhe njoftojë aplikantin për të kryer të plotë pagesën e tarifës për lidhjen e re. Nëse aplikanti nuk kryhen pagesën e tarifës brenda 2 ditëve të punës prej momentit të miratimit dhe njoftimit të tij prej Operatorit të Shpërndarjes të mënyrës së lidhjes së tij në tensionin e mesëm të rrjetit shpërndarës, atëherë aplikimi dhe marrëveshja e lidhjes së re do të konsiderohen të pavlefshme dhe ai duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.

b) Pas pagesës së tarifës së re nga ana e aplikantit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të nxjerrë menjëherë lejen për fillimin e punimeve.

c) Pas përfundimit të punimeve ndërtimore (godina, kanali i kabllove etj.), aplikanti do të njoftojë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për inspektim paraprak dhe nëse punimet janë kryer në përputhje me kushtet teknike atëherë brenda 1 ditë pune, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë pranimin dhe lejojë vazhdimin e punimeve për instalimin e pajisjeve. Nëse gjatë kontrollit konstatohen të meta teknike, atëherë aplikanti është i detyruar të përfundojë apo korrigjojë të metat e konstatuara.

d) Pas përfundimit të instalimeve, përdoruesi apo aplikanti njofton me shkrim Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe brenda 2 ditëve punë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i detyruar të inspektojë dhe të marrë në dorëzim kabinën elektrike nëpërmjet një procesverbali të veçantë. Nëse do të konstatohen të meta, atëherë ato do të riparohen nga ana e përdoruesit apo aplikantit.

e) Pas marrjes në dorëzim të kabinës elektrike, brenda 1 ditë punë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit raportin e vendosjes së sistemit të matjes (matës, bokse kolektive, etj.) së energjisë elektrike i cili duhet të instalohet brenda 2 ditëve punë nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes dhe do të kryhet në prezencë të subjektit të autorizuar sikurse përcaktuar nga ligji për sektorin e energjisë elektrike.

f) Pas vendosjes së sistemit të matjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit urdhrin e vënies nën tension të pajisjeve. Prova dhe vënia nen tension i pajisjeve do të kryhet brenda 1 ditë punë dhe do të kryhet nga strukturat përgjegjëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

g) Në rast së gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen (të instaluara nga aplikanti) atëherë aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jofunksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.

h) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron aplikantin/klientin apo përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij/tyre, së bashku me kontratën e furnizimit me energji elektrike brenda 5 ditëve pune pas vënies në tension. Operatori i Sistemit vë në dispozicion të subjektit të autorizuar informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.

2.4 Burimet e reja të gjenerimit të energjisë elektrike

Aplikimi për lidhje të re për burime të reja të gjenerimit në rrjetin e tensionit të mesëm me fuqi të instaluar më shumë se 50 kW do të bëhet pranë zyrave të Kujdesit të Klientit te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në Tiranë.

1. Periudha e vlerësimit të kërkesës së bërë nga aplikanti dhe paraqitja për nënshkrim e "Marrëveshjes së lidhjes së re" nuk do të jetë jo më shumë së 20 ditë punë prej datës së paraqitjes së aplikimit.

2. Aplikanti duhet të ketë miratuar paraprakisht nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT) projektin elektrik të burimit të gjenerimit që kërkohet të lidhet me rrjetin e shpërndarjes. Ky projekt duhet të pasqyrojë të gjitha detajet teknike dhe parametrat e kryesorë të pajisjeve, së bashku me skemën principiale të tij.

3. Aplikanti do të paraqesë projektin e lidhjes elektrike të burimit të gjenerimit me sistemin e shpërndarjes pas nënshkrimit të marrëveshjes së lidhjes së re, nëpërmjet urdhrit për fillimin e projektimit që do të nxirret nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti dhe nëse aplikimi nuk është i plotë, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë aplikantin me shkrim brenda 5 ditëve të punës prej datës kur aplikimi është dorëzuar për vlerësim.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe në varësi të gjendjes së rrjetit elektrik në atë zonë do të përgatisë mënyrën e lidhjes së objektit në rrjet. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë propozimin dhe Marrëveshjen për lidhjen e re dhe do t'ia dërgojë aplikantit për pranim sipas afateve të pikës 2.4 "a".

6. Nëse aplikanti bie dakord me propozimin e paraqitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për t'u lidhur në sistemin e tij të shpërndarjes, ai duhet të firmosë formularin e pranimit të propozimit dhe marrëveshjen e lidhjes së re brenda afatit prej 10 ditësh kalendarike. Në rast të kundërt propozimi dhe marrëveshja bëhet e pavlefshme dhe kërkesa për lidhje të re duhet të përsëritet.

7. Nëse aplikanti pranon propozimin, atëherë ai dorëzon formularin e pranimit të propozimit dhe nënshkruan dhe e dorëzon marrëveshjen e lidhjes së re tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Brenda 2 ditëve punë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë lejen për fillimin e projektit në përputhje me kërkesat dhe kushtet teknike të paraqitura në Marrëveshjen e lidhjes.

8. Pas dorëzimit të projektit të detajuar, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet ta analizojë atë dhe nëse projekti është në përputhje me kushtet teknike atëherë brenda 2 ditëve punë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të miratojë projektin dhe do të njoftojë aplikantin për kryerjen e pagesës së plotë të tarifës për lidhjen e re. Nëse aplikanti nuk kryhen pagesën e tarifës brenda 10 ditëve kalendarike prej momentit të miratimit të mënyrës së lidhjes së tij në rrjetin shpërndarës, atëherë aplikimi dhe marrëveshja e lidhjes së re do të konsiderohen të pavlefshëm dhe i interesuari do të duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.

9. Pas pagesës së tarifës së lidhjes së re nga ana e aplikantit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të nxjerrë menjëherë lejen për fillimin e punimeve.

10. Pas përfundimit të punimeve dhe instalimeve, aplikanti njofton me shkrim Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe brenda 2 ditëve punë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i detyruar të inspektojë dhe të marrë në dorëzim punimet dhe instalimet e kryera nëpërmjet një procesverbali të veçantë. Nëse do të konstatohen të meta, atëherë ato do të riparohen nga ana aplikantit.

11. Aplikanti bashkëpunon me blerësin e energjisë elektrike për të realizuar vendosjen e sistemit të matjes së energjisë elektrike në burimin e energjisë, në përputhje me kërkesat e Kodit të Matjes.

12. Pas vendosjes së sistemit të matjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit urdhrin e vënies nën tension të pajisjeve. Prova dhe vënia nën tension i pajisjeve do të kryhet brenda 2 ditëve punë dhe do të kryhet nga strukturat përgjegjëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

13. Në rast se gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen (të instaluara nga aplikanti), atëherë aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jofunksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.

2.5 Projektimi

a) Përdoruesi apo aplikanti do të përgatisë projektin e objektit që do të lidhet me sistemin shpërndarës, si edhe projektin e linjës dhe kabinës elektrike në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

b) Projekti i paraqitur duhet të respektojë të gjithë legjislacionin në fuqi, veçanërisht parimet e mbrojtjes së sigurimit teknik dhe sigurisë së punës të instalimeve elektrike për të garantuar që shtesa që do të bëhet në rrjetin e shpërndarjes të jetë në gjendje të shfrytëzohet dhe mirëmbahet në mënyrë të sigurt dhe efektive.

c) Për përcaktimin e vendndodhjes së kabinës së transformimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të marrë në konsideratë mundësinë e hyrjes pa probleme në ambient, si edhe përjashtimin e faktorëve që lidhen me zhurmat dhe rrezikun nga përmbytjet në përputhje me standardet e vetë kompanisë.

d) Pajisjet që do të realizojnë lidhjen e re duhet të jenë të reja dhe parametrat nominalë të tyre: përcjellësit, kabllot, transformator, cela TM, panele të TU, mate, TRR, etj.) duhet të jenë në përputhje me tipin dhe kërkesat teknike të parashikuara në standardet e kërkuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

e) Tokëzimi i kabinës së transformimit do të jetë konform legjislacionit në fuqi dhe rezistenca ohmike e saj do të jetë konform rregullave të sigurimit teknik.

f) Tokëzimi i shtyllave për rrjetin ajror të tensionit të mesëm do të ketë rezistencë tokëzimi të përsëritur e do të jetë konform rregullave të sigurimit teknik.

2.6 Procedura për zhvendosjen e aseteve te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Për nevoja të ndryshme të subjekteve, mund të kërkohet të zhvendosen ose të zëvendësohen asete të ndryshme të kompanisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (linjë ajrore, linjë kabllore, shtylla, kabina elektrike etj.).

Realizimi i zëvendësimit apo i zhvendosjeve të tilla do të bëhet vetëm pas miratimit paraprak të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në pikat 2.1,2.3 dhe 2.4 të kësaj rregulloreje.

Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të miratojë zhvendosjen, atëherë ajo do të kryhet sipas kushteve teknike të vetë kompanisë dhe të gjitha shpenzimet për realizimin e zhvendosjes së aseteve do të përballohen nga aplikanti sipas preventivit të miratuar nga Operatori i Sistemi të Shpërndarjes.

2.7 Mënyra e lidhjes në rrjet të burimeve të energjisë

Burimet e energjisë elektrike do të lidhen në rrjetin shpërndarës pasi Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të ketë kryer studimin e lidhjes dhe efektet që sjellin në atë pjesë të rrjetit prania e burimeve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike.

Burimet e reja do të preferohet të lidhen si pjesë shtesë e rrjetit ekzistues 6-10-20-35 kV dhe nëse kjo mënyrë lidhjeje është e pamundur, atëherë do të realizohet lidhja e tyre në n/stacionet e transformimit.

Të gjitha shpenzimet që lidhen me realizimin e lidhjes, përforcimin e pjesës ekzistuese të rrjetit shpërndarës për efekt të realizimit të lidhjes, shtesat e mundshme në pjesën e tensioni të mesëm 35 kV dhe të tensionit të lartë në n/stacione (kur kërkohet lidhja në to) do të përballohen nga aplikanti.

PJESA III: DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR APLIKIM

3.1 Dokumentacioni që kërkohet për lidhje të re ose modifikim lidhjeje ekzistuese në tension të ulët për fuqi të instaluar deri në 20 kW:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike (formulari i aplikimit).
2. Vërtetim i identitetit (fotokopje e kartë identiteti ose pasaportë).
3. Fotokopje e certifikatës së regjistrimit në QKR (për subjektet jofamiljare).
4. Genplani i vendosjes së objektit.
5. Kopje e kontratës (kartelës) së mëparshme që aplikanti mund të ketë pasur.
6. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronës, të tilla si: Akt shitjeje, akt qiraje, akt dhurimi ose akt ndarje prone të patundshme.

3.2 Informacioni që kërkohet për fuqi të instaluar 21-50 kW.

1. Dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 3.1, si edhe dokumentet e tjera të mëposhtme
2. Projekti elektrik i objektit i miratuar paraprakisht nga IQT, i cili përmban vetëm objektin për të cilin po aplikohet për lidhje të re.
3. Plan-vendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.
4. Parametrat nominalë të të gjitha pajisjeve elektrike të përfshira në projektin elektrik.
5. Licencë e inxhinierit elektrik i cili ka bërë projektin elektrik të objektit.
6. Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përllogaritja e të dhënave të kryera nga inxhinierë me licencë.

3.3 Informacioni që kërkohet për fuqi të instaluar mbi 50 kW:

1. Dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 3.2, si edhe dokumentet e tjera të mëposhtme:
2. Leje e ndërtimit të objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike;
3. Grafiku i ngarkesës elektrike;
4. Relacioni analitik për vlerësimin e cos φ dhe kompensimin e saj;

3.4 Informacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese:

1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (formulari i aplikimit).
2. Fotokopje e vërtetim i identitetit (kartë identiteti ose pasaportë).

3. Certifikatë regjistrimi në QKR (për subjektet jofamiljare).
4. Gen-Plan i vendosjes së objektit.
5. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme.
6. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
7. Projektin e plotë të nyjës se si do lidhet objekti i ri në rrjetin shpërndarës.
8. Kopje të licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
9. Kopje e kontratës (kartelës) së mëparshme që aplikanti mund të këtë pasur.
10. Kontrata e koncesionit për ndërtimin e burimit gjenerues.
11. Llojin e burimit gjenerues dhe parametrat nominalë të tij përfshirë edhe X (d).
12. Fuqia maksimale e gjeneruar aktive dhe reaktive.
13. Skema principiale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike.
14. Tipi i gjeneratorit sinkron dhe parametrat e tij.
15. Parametrat kryesorë të transformatorit të fuqisë.

3.5 Projektimi i kabinës së transformimit dhe mënyrës së lidhjes

a) Për pikën e lidhjes së miratuar, aplikanti do të kryejë projektin ndërtimor dhe atë elektrik për kabinën e transformimit (n.q.s. është parashikuar në ofertën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) dhe mënyrën e lidhjes së saj me rrjetin e shpërndarjes. Projekti elektrik duhet të realizohet nga një inxhinier elektrik me licencë dhe duhet të miratohet paraprakisht nga ana e Inspektoratit Qendror Teknik (IQT).

b) Projekti do të përmbajë të gjitha kërkesat, siç specifikohen më poshtë:

- Planimetria dhe vendndodhja e kabinës së transformimit si pjesë përbërëse e projektit ndërtimor në tërësi;
- Projektimi ndërtimor i detajuar i pikës së transformimit (përfshirë të gjitha prerjet tërthore të godinës së kabinës);
- Plani i vendosjes i të gjitha pajisjeve brenda pikës së transformimit;
- Planimetria e vendosjes së kabllove elektrike brenda dhe jashtë kabinës, si edhe prerja tërthorë e kanaleve të kabllove;
- Skema elektrike principale e kabinës elektrike, duke pasqyruar të gjithë parametrat nominalë të pajisjeve elektrike, si edhe të gjitha detajet e tjera që lidhen me realizimin në tërësi të saj;
- Sistemi i tokëzimit të kabinës dhe të gjitha detajet që lidhen me realizimin e tij, brenda dhe jashtë kabinës elektrike;
- Projektimi i linjave ajrore/linjave kabllore të fuqisë (TM-TU) dhe profili i linjës në shkallën 1:1000.

c) Projektimi dhe përzgjedhja e pajisjeve do të bëhet në përputhje me tipin dhe specifikimet teknike të bëra të njohura paraprakisht nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes pas pranimit të ofertës nga ana e aplikantit.

3.6 Vlefshmëria e dokumentacionit të paraqitur

a) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

b) Nëse nga vlerësimi paraprak i të dhënave të mësipërme dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i pamjaftueshëm, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtë t'i kërkojë aplikuesit të dhëna shtesë.

PJESA V: TARIFAT PËR LIDHJET E REJA

5.1 Parimet e tarifave

a) Tarifat për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike janë përcaktuar në përputhje me objektivat e mposhtëm:

1. Mosdiskriminim;
2. Transparencë që lidhet me përdorimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe pjesëve integrale të tij;

3. Zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, në mënyrë që të sigurohet ruajtja e nivelit së cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

b) Tarifat për lidhjet e reja janë të njëjta për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

c) Parimi kryesor për detyrimin për realizimin e lidhjes së re është: "Ai person fizik apo juridik që kërkon ndryshime në rrjetin e shpërndarjes, do të mbulojë të gjitha shpenzimet që lidhen me ndryshimin e rrjetit të shpërndarjes për të realizuar lidhjen e re.".

5.2 Punimet/shërbimet që do të paguhen nga aplikanti

a) Aplikuesi do të paguajë koston që lidhet me shërbimet që do të kryhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe që përfshihen në tarifë, si më poshtë:

- Pranimi dhe procesimi i aplikimit;
- Planifikimi i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për të mundësuar lidhjen e objektit të ri;
- Përcaktimi i pikës së lidhjes në sistemin e shpërndarjes;
- Miratimi i projektimit të paraqitur nga aplikanti;
- Inspektimi, monitorimi i punimeve ndërtimore dhe instalimeve;
- Instalimi i aparateve matës të energjisë elektrike.
- 50ml kabllo (koaksial ose fuqie sipas rasteve) për instalimin e matësit në abonentët e pajisur me matës energjie me boks individual etj.;
- Lidhja me rrjetin e shpërndarjes të Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

b) Punimet/ shërbimet që do të kryhen dhe përballohen nga aplikanti janë:

- Projektimi për realizimin e lidhjes së re;
- Kryerja e të gjitha punimeve me karakter ndërtimor (kabina, kanalet e kabllove, etj.)
- Blerja dhe instalimi i pajisjeve dhe materialeve sipas tipit dhe specifikimeve teknike e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në përputhje me projektin e miratuar paraprakisht.
- Koston e pjesës së kabllos më shumë së 50 ml, vlera e të cilit do të përcaktohet referuar çmimit mesatar të kësaj kablloje në librat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (abonentët e pajisur me matës energjie me boks individualë).
- Hapja e kanaleve të kabllove për realizimin e nyejve bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike që realizojnë lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, mufte, etj.), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë edhe sistemet rrugore.
- Testimi i lidhjes së realizuar, etj.

5.3 Mënyra e pagesës

a) Aplikanti duhet të kryejë një pagesë për tarifën e lidhjes së re, e cila mbulon shpenzimet e përcaktuara sipas 5.2. "a".

b) Aplikanti do të mbulojë vetë shpenzimet e të gjitha punimeve dhe pajisjeve shtesë që janë të nevojshme për të realizuar lidhjen e re, të përcaktuara sipas 5.2. "b".

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të zbatojë praktikën e pagesës së plotë në avancë për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese.

d) Në fund të kryerjes së punimeve Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë një faturë të detajuar të sasive dhe çmimeve të punimeve dhe materialeve të përdorura faktikisht për realizimin e lidhjes së re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, tek e cila në asnjë rast çmimet e përdorura nuk mund të jenë më të larta se vlera në treg e të njëjtit mall në momentin e realizimit të punimeve të lidhjes. Në rast diferencash mes preventivit të punimeve dhe kostove reale, palët sipas rastit do të paguajnë diferencat ose do t'ia rimbursojnë ato palës tjetër.

5.4 Struktura e tarifave të lidhjes së re

a) Tarifat për një lidhje të re ose modifikim lidhjeje ekzistuese (tarifat e lidhjes) do të llogariten duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në këtë rregullore.

b) Tarifat e lidhjes do të varen nga kërkesat e aplikantit, disponibiliteti i rrjetit të shpërndarjes tek pika e lidhjes, fuqia rezervë (nëse ka) tek pika e lidhjes dhe karakteristika të tjera që lidhen me realizimin e saj, duke përfshirë fuqinë e kërkuar dhe nivelin e tensionit.

c) Tarifat e lidhjes përbëhen nga tarifat e mëposhtme: T1, T2, T3, dhe T4

T1 – Tarifa e studimit dhe vlerësimit e miratimit të projektimit.

T2 – Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re.

T3 – Tarifa e fuqisë (lekë/kw fuqi të kërkuar).

T4 – Tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike.

5.5 Kushtet të tjera për lidhje në rrjetin shpërndarës

a) Rrjeti trefazor i tensionit të ulët 0,4 kV

Fuqia minimale e instaluar për të realizuar lidhjen e energjisë elektrike në tension të ulët 0,4 kV do të jetë deri 5 kW për rrjetin 1-fazor dhe mbi 5 kW për rrjetin 3-fazor.

b) Rrjeti i tensionit 6,10 kV

Rrjeti me tension 6 dhe 10 kV është në proces kalimi dhe transferimi në rrjetin me shkallë tensioni 20 kV. Në këtë fazë kalimtare, mënyra e realizimit të lidhjeve të reja në rrjetin e tensionit të mesëm 6, 10 kV, kur parashikohet ndërtimi i kabinës elektrike, do të realizohet me thikë-siguresë të TM. Aplikanti do të jetë vetë përgjegjës për ndryshimin e pajisjeve dhe kryerjen e punimeve nëse në të ardhmen ky rrjet shpërndarës pranë objektit që është lidhur do të zëvendësohet me rrjetin 20 kV.

c) Rrjeti i tensionit 20 kV

Lidhja e kabinave elektrike në rrjetin shpërndarës me tension 20 kV do realizohet nëpërmjet celave (paneleve) të TM sipas strukturës: Cele hyrje- Cele dalje dhe cele transformatori.

d) Kabinat shtyllore 6, 10, 20 kV

Kabinat shtyllore do të përdoren kryesisht në zonat rurale, por ato mund të ndërtohen edhe në zona urbane, në varësi të analizës dhe vendimit të vetë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Mënyra e realizimit të tyre do të jetë sipas skemës: “thikë-siguresë-shkarkues” dhe fuqia e transformatorit të fuqisë do të jetë 50-400 kVA.

Nëse disa konsumatorë kanë kontratë të vlefshme furnizimi me energji elektrike dhe kërkojnë të ndërtojnë një kabinë në zonë rurale me qëllim përmirësimin e cilësisë së furnizimit, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të miratojë kërkesën e tyre, pavarësisht së këta konsumatorë mund të mos kenë dokumentet që vërtetojnë legalizimin e banesës së tyre. Në këto raste do të transferohen asetet e lidhjes në pronësi te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

e) Rrjeti i tensionit 35 kV

Pranimi dhe mënyra e realizimit të lidhjeve të reja në rrjetin e tensionit 35 kV do të bëhen në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe rregullat e brendshme te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Mënyra e realizimit të tyre do të jetë sipas skemës: “thikë-siguresë-shkarkues” dhe fuqia minimale e transformatorit të fuqisë për të pranuar vlerësimin e aplikimeve në këtë rrjet tensioni do të jetë 800 kVA.

f) Fuqizimi i kabinave të transformimit 6, 10, 20 kV në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kryhen analizën dhe vlerësimin së njësive të transformimit që ndodhen pranë vendndodhjes së objektit të ri që kërkon lidhje të re apo shtesë fuqie. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të vlerësojë çdo rast dhe në varësi të gjendjes së rrjetit, gjendjes së kabinës ekzistuese, mundësive reale për transformatorë fuqie rezervë; perspektivës së zhvillimit në atë zonë; ai (OSSH) mund të vendosë të bëjë vetë fuqizimin e kabinës ekzistuese dhe aplikanti të lidhet në tensionin e ulët duke paguar tarifat respektive.

5.6. Tarifat për lidhje në tension të ulët

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të ulët 0.4 kV

a) Konsumatorë familjarë:

T1 = 0 lekë
T2 = 1.200 lekë
T3 = 2,000 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)
T4 = Tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike.
b) Konsumatorët jofamiljarë:
T1 = 0 lekë
T2 = 1.200 lekë
T3 = 2.500 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)
T4 = Tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike.
c) Në lidhje me koston e kabllos

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka detyrimin t'i ofrojë pa pagesë aplikantit kabllon koaksial 2 x 6 mm^2 për instalimim e boksit individual me matës njëfazor për një gjatësi deri në 50 ml.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka detyrimin t'i ofrojë pa pagesë aplikantit kabllon e tensionit të ulët (PVC) për një gjatësi deri në 50 ml.

3. Nëse distanca deri tek pika e lidhjes është më shumë së 50 ml, atëherë aplikanti detyrohet të paguajë koston shtesë për efekt të gjatësisë së kabllos mbi 50 ml, sipas çmimit njësi mesatar të regjistruar në Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për këtë artikull, dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të livrojë dhe instalojë kabllon, pa shkëputje, deri tek pika e lidhjes.

5.7 Tarifat për lidhje në tension të mesëm

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të mesëm 6,10 dhe 20 kV (aplikanti do të ndërtojë kabinë elektrike).

T1 = 4,000 lekë
T2 = 1.200 lekë
T3 = 1.700 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)
T4 = Tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike.
5.8 Tarifat për lidhje në tension të mesëm 35 kV
Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të mesëm 35 kV
T1 = 4,000 lekë
T2 = 1,200 lekë
T3 = 2,000 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)
T4 = Tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike.
5.9 Tarifat për shtesë fuqie
a) Konsumatorë familjarë
T1; T2; = 0 lekë
T3 = 2,000 lekë/kW (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar)
T4 = në përputhje me tarifat e miratuara.
b) Konsumatorët jofamiljarë në tension të ulët
T1; T2; = 0 lekë
T3 = 2.500 lekë/kW (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar)
T4= në përputhje me tarifat e miratuara.
c) Konsumatorët jofamiljarë në tension të mesëm
T1; T2; = 0 lekë
T3 = 1.700 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)
T4= në përputhje me tarifat e miratuara.
d) Konsumatorët jofamiljare në tension 35 kV
T1; T2; = 0 lekë
T3 = 2,000 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4= në përputhje me tarifat e miratuara.

5.10 Tarifat për modifikim ose transferim lidhjeje

Kjo tarifë do të aplikohet vetëm për konsumatorët jofamiljarë dhe shërben për rastet kur konsumatori është i lidhur në rrjet dhe ka paguar tarifat e lidhjes, por kërkon të transferojë pikën e lidhjes ose në një vendndodhje tjetër ose në një tjetër shkallë tensioni të rrjetit shpërndarës.

Në rastet kur kërkohet lidhja në rrjet në një tjetër shkallë tensioni, atëherë konsumatori është përgjegjës për ndryshimin e parametrave të të gjitha aseteve që realizojnë lidhjen në shkallën e re të tensionit.

a) Konsumatorë familjarë

T1; T2; = 0 lekë

T3 = 2,000 lekë/kW (kundrejt fuqisë së modifikuar)

T4 = në përputhje me tarifat e miratuara.

b) Konsumatorët jofamiljarë në tension të ulët

T1; T2; = 0 lekë

T3 = 2.500 lekë/kW (kundrejt fuqisë së shtuar)

T4= në përputhje me tarifat e miratuara.

c) Konsumatorët jofamiljarë në tension të mesëm

T1; T2; = 0 lekë

T3 = 1.700 lekë/kW (kundrejt fuqisë së shtuar)

T4= në përputhje me tarifat e miratuara.

d) Nëse një konsumator jofamiljar ka realizuar një lidhje të re në një vendndodhje të caktuar dhe kërkon ta transferojë atë në një tjetër vend apo në tjetër njësi administrative, atëherë atij i njihen tarifat e lidhjes së re të mëparshme, por mbetet i detyruar të paguajë prej tyre vetëm tarifën T1, T2 sipas pikës 5.10.5. Nëse kjo lëvizje do të shoqërohet edhe me shtesë fuqie, atëherë aplikanti detyrohet të paguajë T1, T2 si më sipër, si edhe vlerën e shtesës së fuqisë.

5.11 Tarifat për lidhje në n/stacione

Lidhja e re në zbarat e rrjetit shpërndarës të n/stacioneve mund të kryhet duke vlerësuar paraprakisht gjendjen ekzistuese të n/stacionit dhe mundësinë e lidhjes në të.

a) Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes disponon cele në impiantin shpërndarës, atëherë aplikanti do të detyrohet të përballojë jo vetëm shpenzimet për ndryshimin e pajisjeve (transformator rrymë, kokë kabllo etj.), por edhe këto tarifa shtesë:

Tarifa e përdorimit të celes ekzistuese 150’000 lekë

Tarifa modifikim lidhjeje 50’000 lekë

b) Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk disponon cele në impiantin shpërndarës, atëherë aplikanti do të sigurojë dhe instalojë vetë celen në objekt dhe detyrohet të paguajë:

Tarifa modifikim lidhjeje 50’000 lekë

c) Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të instalojë vetë një cele në objekt për të realizuar lidhjen e kërkuar, atëherë aplikanti do të detyrohet të paguajë:

Tarifa e përdorimit të celes së re 1’000’000 lekë

Tarifë modifikim lidhjeje 50’000 lekë

d) Për të gjitha rastet e mësipërme, matja dhe faturimi i energjisë elektrike do të bëhet nëpërmjet një paneli matjeje të vendosur në n/stacion sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Matjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për sigurimin dhe instalimin e sistemit matës respektiv.

5.12 Tarifa për rastet e lidhjes nga disa burime të energjisë elektrike

Në përputhje me paragrafin 1.10, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të aplikojë një tarifë shtesë për rastet kur kërkohet dhe miratohet realizimi i lidhjes së re nga dy burime energjie të pavarura.

Për këto raste, përdoruesi ose aplikanti do të paguajë tarifën përkatëse për secilën lidhje sipas kësaj rregulloreje. Procedura dhe kushtet do të jenë të njëjta sikurse në rastin kur lidhja do të realizohej nga një burim i vetëm furnizimi.

5.13 Tarifa T4 për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike

Tarifa T4 e kolaudimit fillestar të matësve të energjisë elektrike do të paguhet nga aplikanti dhe do të bëhet në prezencë të subjektit të autorizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5.14 Tarifa lidhjen e burimeve të gjenerimit të energjisë elektrike

Për rastin kur në sistemin e shpërndarjes do të lidhen burime të gjenerimit të energjisë elektrike, tarifa e lidhjes do të përbëhet vetëm nga këto komponentë:

T1 = 10'000 lekë

T2 = 100'000 lekë

T3 = 0

T4 = Tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike

Në rast se lidhja e burimeve të energjisë do të bëhet në zbarat e rrjetit shpërndarës të n/stacioneve në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, atëherë do të aplikohen edhe tarifat shtesë sikurse janë përcaktuar në pikën 5.11.

5.15 Kontrolli i kërkesës maksimale për fuqi

a) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kontrollojë kërkesën maksimale për furnizimin me energji elektrike nga çdo konsumator i lidhur në tension të ulët, duke përdorur automat ngarkese.

b) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kontrollojë kërkesën maksimale nga çdo konsumator i lidhur në tension të mesëm duke përzgjedhur koeficientin e përshtatshëm të transformimit të transformatorit të rrymës.

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për të siguruar dhe instaluar sistemin e matjes (boks individual me matës, boks kolektiv me matës, matës, transformatorët e rrymës, cele e matjes së bashku me transformatorët e rrymës dhe ata të tensionit, në objektin që kërkohet të lidhet me energji elektrike, në kabinën elektrike dhe në n/stacionin elektrik, etj.).

PJESA VI: PRONËSIA MBI LIDHJEN E RE

6.1 Kufijtë e pronësisë

a) Për sa i përket përdoruesve ose aplikantëve që kërkojnë pikë lidhjeje në tension të mesëm, kufijtë e pronësisë do të jenë të përcaktuar në çdo rast nga marrëveshje të veçanta ndërmjet palëve.

b) Linjat e lidhjes së tensionit të ulët dhe ato të tensionit të mesëm si asete të lidhjes do të jenë gjithmonë pronë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

c) Në të gjitha rastet, kur poseduesi i kabinës është një person fizik apo juridik, cela e hyrjes dhe ajo e daljes në kabinën e tij do të jenë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe kufiri i pronësisë do të jetë cela e transformatorit. Matja e energjisë do të kryhet në tensionin e mesëm dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk mban përgjegjësi për pjesën tjetër të aseteve që nuk janë në pronësi të tij.

d) Nëse nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes jepet miratimi për pikën e lidhjes së re në kabinën elektrike në pronësi të një subjekti privat, atëherë të gjitha asetet e lidhjes (pajisjet elektrike të kabinës) i transferohen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, duke kompensuar poseduesin e mëparshëm të kabinës për pjesën e tarifës T3 që i korrespondon fuqisë së kërkuar nga poseduesi i ri, pasi të jetë realizuar transferimi i pronësisë së pajisjeve.

6.2 Marrëveshja për kalimin e pronësinë

a) Kur një subjekt pronar i kabinës dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes bien dakord për të transferuar pajisjet elektrike të kabinës elektrike (kontratë shitblerjeje e pasurive të luajtshme) nga pronari tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kompensojë pronarin me vlerën e tarifës së fuqisë (T3).

b) Nëse aplikanti ka ndërtuar një objekt të mëparshëm, për të cilin ka ndërtuar edhe kabinën elektrike dhe kërkon të lidhë edhe një tjetër objekt të ri në po atë kabinë, atëherë kompensimi do të bëhet për tarifën T3 të objektit të parë dhe atë të objektit/objekteve të ri/reja. Aplikanti mund të fuqizojë paraprakisht kabinën ekzistuese në pronësi të tij për të lidhur objektin tjetër dhe kompensimi do të bëhet po sipas pikës 6.2. "a", duke u kompensuar jo vetëm për objektin/objektet e mëparshme, por edhe për objektin/objektet e reja.

c) Tarifa T3 për objektet e reja do të paguhet paraprakisht, kurse kompensimi me tarifën T3, e parashikuar sipas pikave 6.2. "a" dhe 6.2. "b" do të kryhet vetëm pasi aplikanti të ketë nënshkruar me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes kontratën e shitblerjes së pasurive të luajtshme.

d) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të zbatojë kompensimin nëpërmjet tarifës T3 edhe në rastet kur pronari nuk disponon certifikatën e pronësisë mbi kabinën elektrike, por e dokumenton atë nëpërmjet Marrëveshjes së lidhjes me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

e) Në rast se një apo disa përdorues apo aplikantë kërkojnë të ndërtojnë një kabinë të re transformimi për nevojat e tyre, të gjitha shpenzimet për realizimin e kësaj lidhjeje të re do të përballohen nga vetë përdoruesi apo aplikanti. Në këtë rast ata duhet të nënshkruajnë një marrëveshje të përbashkët dhe duhet që të transferojnë asetet tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duke iu falur tarifa T3 për këtë lidhje të re, nëpërmjet kontratës së shitblerjes së pasurive të luajtshme.

6.3 Të drejtat e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme

a) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të blejë ose të ketë të drejtën e uzufruktit pa shpërblim mbi pasurinë e paluajtshme me destinacion kabinë elektrike.

b) Uzufrukti do të krijohet me marrëveshje noteriale midis palëve për një afat 30-vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje dhe do të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Ndryshimi i pronarit të pasurisë së paluajtshme nuk do të cenojë të drejtën e uzufruktit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

c) Marrëveshja e uzufruktit midis palëve do të realizohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 i ndryshuar).

PJESA VII: DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

7.1 Asetet e paluajtshme të përfituara "pa shpërblim" nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas kësaj rregullore nuk do të përfshihen në bazën e rregulluar të aseteve, për efekt të llogaritjes së tarifave.

7.2 Kjo rregullore është objekt rishikimi, me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, sipas "Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s".

7.3 Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MARRËVESHJE E LIDHJES SË RE

Nr. Prot [ ] Tiranë më [ ]

Midis palëve:

CEZ Shpërndarje

[ ]

Klienti

[ ]

AKTMARRËVESHJE

Kjo marrëveshje lidhet më datë: [ ]

NDËRMJET:

1. Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, "CEZ shpërndarje" sh.a., me seli qendrore në adresën: rruga "Abdyl Frashëri; EGT Tower, pallati 12/1, Tiranë (këtu e më poshtë referuar me termin "CEZ shpërndarje"); përfaqësuar nga [ ]

2. [ ] me në adresën [ ], regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr. NIPT [ ] (këtu e më poshtë referuar me termin "Klienti"), përfaqësuar nga z. [ ]

KU:

Klienti ka aplikuar në "CEZ shpërndarje" dhe "CEZ shpërndarje" ka rënë dakord për lidhjen e objektit me sistemin e shpërndarjes në pikën e lidhjes, sipas afateve dhe kushteve të kësaj marrëveshje tip të miratuar prej Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

Është rënë dakord si më poshtë:

1. Objekti i aktmarrëveshjes

Kjo aktmarrëveshje ka për objekt furnizimin me energji elektrike të objektit [ ] me adresë [ ], sipas kërkesës së vetë klientit shoqëria [ ] e cila merr përsipër ndërtimin e kabinës elektrike me transformator [ ] kVA, [ ] kV, si edhe linjës [ajrore/kabllore] me tension [ ] kV dhe me seksion [..... mm^2], që do të shërbejnë për furnizimin me energji elektrike të objektit për sa më lart sipas propozimit datë: [ ], Nr.Prot: [ ]

2. Baza ligjore e aktmarrëveshjes

- Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrikë", i ndryshuar.
- Vendimi nr. 22, datë 25.2.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e rregullores së lidhjeve të reja "

3. Kushtet e aplikueshme

Kjo marrëveshje (përfshirë të gjitha anekset) përcakton kushtet e përgjithshme të "CEZ shpërndarje" për lidhjen e konsumatorëve me sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

4. Marrëveshja për lidhjen

4.1 Në varësi të afateve dhe kushteve të kësaj marrëveshjeje, "CEZ shpërndarje" bie dakord të lidhë objektin me sistemin e shpërndarjes në pikën e lidhjes dhe pajisjet e lidhjes që do të furnizohen me energji nga data e lidhjes së objektit me afat kohor të papërcaktuar.

4.2 Përpara fillimit të punimeve për realizimin e lidhjes së re, klienti duhet të paguajë çdo tarifë të përcaktuar në lidhje me ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje.

5. Tarifat

5.1 Klienti duhet t'i paguajë "CEZ shpërndarje" të gjitha tarifat e përcaktuara sipas kësaj marrëveshjeje.

5.2 Të gjitha shumat e paguara nga klienti në "CEZ shpërndarje", sipas kësaj marrëveshje, do të kryhen të plota dhe pa asnjë zbritje dhe pa shtyrje afati.

6. Përfaqësimet

Të dyja palët përfaqësojnë dhe garantojnë njëra-tjetrën vazhdimisht gjatë kohëzgjatjes së aktmarrëveshjes se ato kanë fuqi dhe autoritet të plotë për të lidhur dhe zbatuar këtë marrëveshje. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të bjerë ndesh, nuk do të shkel ose nuk do të dëmtojë asnjë kontratë, marrëveshje, gjykim, statut, urdhëresë ose rregullore që mund të jenë detyruese për njërën nga palët.

7. Ndryshimet

7.1 Asnjë ndryshim i kësaj marrëveshjeje nuk do të jetë efektiv nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

7.2 Secila palë mund të lajmërojë në çdo kohë palën tjetër për të propozuar se kjo Marrëveshje duhet të ndryshohet.

7.3 Nëse ndryshimi i propozuar sipas kësaj dispozite nuk pranohet nga palët brenda (1) një muaji nga data e propozimit, secila Palë mund t'ia dërgojë ERE-s çështjen për zgjidhje. Palët do të jenë të detyruara të pranojnë vendimin e ERE-s dhe ta vënë në zbatim. Dhe, nëse është e mundur, ato mund të lidhin një marrëveshje plotësuese që mund t'i bashkëngjitet kësaj Marrëveshje.

8. E drejta e shfrytëzimit

Klienti do të lejojë punonjësit, nënkontraktorët, agjentët ose konsulentët e "CEZ shpërndarje" në periudhat kur është rënë dakord nga palët-edhe gjatë afatit të kësaj marrëveshjeje-të hyjnë në ato pjesë të ambienteve të klientit me qëllim që të kryejnë punime për lidhje ose për modifikime apo për të operuar, lexuar matësit, inspektuar, testuar pajisjet e matjes, punuar me pajisjet e "CEZ shpërndarje" ose të objektit, për të shkëputur pikën e lidhjes ose për t'i mundësuar "CEZ shpërndarje" të përmbushë detyrimet e veta sipas kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshjeje. "CEZ shpërndarje" do t'i jepet akses i sigurt dhe i papenguar.

Të gjitha të drejtat për akses që i jepen "CEZ shpërndarje" për shfrytëzimin e pajisjeve dhe linjës së furnizimit sipas kësaj marrëveshjeje do të përfshijnë: të drejtën e kalimit të automjeteve, të drejtën e ngritjes së impianteve, të drejtën e përdorimit të pajisjeve dhe linjës sipas nevojave. Këto të drejta janë të nevojshme për të kryer funksionet në bazë të të cilave është dhënë e drejta e aksesit. Të gjitha të drejtat do të ushtrohen pa asnjë tarifë. Punonjësit e "CEZ shpërndarje" do të përpiqen maksimalisht për të bashkëpunuar me klientin gjatë kohës qe punojnë në ambientet e klientit.

9. Punimet për lidhjen

9.1 Të gjitha punimet për realizimin e lidhjes me sistemin e shpërndarjes do të kryhen nga klienti me shpenzimet e tij.

9.2 Klienti do të kryejë punimet për lidhjen e tij në përputhje me letrën e "Propozimit për lidhjen e re" dhe do të marrë ato miratime që janë të nevojshme për të për këtë qëllim me shpenzimet e veta (leje punimesh, miratime të ndryshme, etj.).

9.3 Verifikimet e rregullshmërisë së kryerjes së punimeve dhe instalimeve janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

9.4 Klienti do të njoftojë paraprakisht "CEZ shpërndarje" kur ai do të jetë gati për kryerjen e verifikimeve dhe testimeve.

9.5 "CEZ shpërndarje" nuk do të lidhë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike nëse nuk është kryer prej tyre verifikimi dhe kontrolli i punimeve dhe pajisjeve elektrike të instaluara për këtë qëllim.

10. Kufizimi i kërkesës për energji elektrike

10.1 Klienti nuk do të furnizohet me energji nëpërmjet pikës së lidhjes në rast se nga ana e tij rritet fuqia maksimale e kërkuar, siç është rënë dakord në ofertën e lidhjes se re.

10.2 Nëse fuqia maksimale e kërkuar kërkohet të rritet, atëherë klienti duhet të aplikojë për shtesë fuqie sipas rregullave dhe tarifave në fuqi.

10.3 Klienti nuk ka të drejtë të shfrytëzojë pajisjet e kabinës elektrike dhe linjën e tensionit të mesëm për qëllime të tjera jashtë kësaj marrëveshje.

11. Faktori i fuqisë dhe simetrizimi i fazës

Klienti do të ndërmarrë të gjitha masat që të ruhet faktori i fuqisë së ngarkesës së plotë në Pikën e Lidhjes për energjinë e importuar në vlerën 0,90 dhe simetrizimi i ngarkesës së fazave jo më shumë se 3%.

12. Pajisjet e matjes

12.1 "CEZ shpërndarje" do të instalojë dhe kolaudojë pajisjet e sistemit të matjes në çdo pikë të lidhjes në përputhje me Kodin e Matjes.

12.2 Klienti nuk do të ndërhyjë apo lejojë ndonjë ndërhyrje ne sistemin e matjes dhe do të dëmshpërblejë "CEZ shpërndarje" në rast të ndonjë ndërhyrjeje.

12.3 Në rast se njëra nga palët ka motive për të besuar se pajisjet e matjes operojnë jashtë klasit të gabimit të lejuar, atëherë ajo njofton menjëherë palën tjetër. Në këtë mënyrë, pajisjet matëse do të kontrollohen/kolaudohen nga laborator i certifikuar i pavarur. Nëse gjatë testimit të pajisjeve të matjes:

a) rezulton që pajisjet e matjes operojnë jashtë klasit të gabimit të lejuar, ato do të rikolaudohen ose zëvendësohen dhe shpenzimet e këtij test, si edhe të rikolaudimit ose zëvendësimi do të mbulohen nga "CEZ shpërndarje";

b) rezulton që pajisjet e matjes operojnë brenda klasit të gabimit të lejuar, shpenzimet e këtij ekzaminimi dhe testimi do të paguhen nga klienti nëse ai (klienti) i ka kërkuar "CEZ shpërndarje" të kryejë testime të tilla për pajisjet e matjes.

13. Perspektiva e zhvillimit të rrjetit shpërndarës

"CEZ shpërndarje" do të zhvillojë vazhdimisht rrjetin e shpërndarjes dhe zgjidhja afatgjatë parashikon zëvendësimin e rrjetave 6;10 dhe 35 kV me rrjeta me tension 20 kV. Nëse asetet e lidhjes suaj i përkasin një niveli tjetër tensioni (6; 10 ose 35kV) dhe zhvillimi i ardhshëm kërkon zëvendësimin e tyre me një rrjet 20kV, atëherë klienti do të bej zëvendësimin (sipas një afati të rënë dakord midis palëve) e pajisjeve me qëllim që ato të përshtaten me nivelin e ri të tensionit.

14. Transferimi i pronësisë së pajisjeve të kabinës

Klienti do t'i transferojë "CEZ shpërndarje" sh.a. të drejtën e pronësisë mbi pajisjet e kabinës elektrike nëpërmjet kontratës së shitblerjes në përputhje me pikën 6.2 të rregullores, në shumën prej [ ] lekë, siç është përcaktuar në "Propozimin e lidhjes së re"

15. Trajtimi i pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme

Pasuria e paluajtshme me destinacion kabine elektrike do të bëhet pronë e shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a. nëpërmjet blerjes së saj. Në rast se palët nuk bien dakord për realizimin e kontratës se shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, atëherë do të procedohet me krijimin e uzufruktit pa shpërblim në respektim të nenit 6.3.2 e në vijim të rregullores për lidhjet e reja.

16. Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje (së bashku me të gjitha dokumentet bashkëngjitur) përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve për sa i përket subjektit të saj. Kjo Marrëveshje zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme ndërmjet palëve për sa i përket subjektit të saj. Secila palë pranon dhe konfirmon se ajo nuk e nënshkruan këtë marrëveshje në besueshmëri të një përfaqësimi, garancie apo sipërmarrje tjetër nga pala tjetër, nëse nuk reflektohen plotësisht në këtë Marrëveshje.

17. Ligji i aplikuar

Marrëveshja do të interpretohet, shpjegohet dhe administrohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe të dyja palët do t'i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të gjykatave shqiptare.

18. Zgjidhja e konflikteve

Nëse deklarohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore, për çdo konflikt ose mospajtim që lidhet me këtë Marrëveshje, palët do t'i drejtohen ERE-s.

Nën praninë e secilës prej palëve, personat e autorizuar të palëve nënshkruajnë për sa u përshkrua më sipër këtë Marrëveshje.

Klienti CEZ Shpërndarje

[ ] [ ]

ANEKSI 1
DETAJET BANKARE "CEZ SHPËRNDARJE" SHA

Banka	Numri i Llogarisë
Banka Popullore	00000870008
Credins Bank	125683
Emporiki Bank	000405016
First Investment Bank	1 0000 0282 0200
Intesa San Paolo	20442735316
National Bank of Greece	188099-11-000-04-1
National Commercial Bank	AL60 2051 1014 2190 00CL
Procredit Bank	108233760301
Raiffesen Bank	7000297663
Tirana Bank	0100308121103
Union Bank	111279195020718

ANEKSI 2
KUSHTET TEKNIKE TË REALIZIMIT TË LIDHJES SE RE

Specifikimet teknike qe nevojiten për të realizuar një lidhje të re në rrjetin shpërndarës së energjisë elektrike

Pjesa 1 _Kërkesa të përgjithshme për kabinën elektrike
Pjesa 2 _Kushtet teknike për kabinën elektrike
Pjesa 3 _Kushtet teknike për punimet me karakter ndërtimor
Pjesa 4 _Kushtet teknike mbi sistemin e tokëzimit
Pjesa 5 _Kërkesat në lidhje me skemën elektrike principiale
Pjesa 6 _Kushtet teknike të ndërtimit të kabinave shtyllore
Pjesa 7 _Kushtet teknike mbi ndërtimin e linjave të tensionit të mesëm
Pjesa 8 _Kushtet teknike të përgatitjes se kanalit të kabllove
Pjesa 9 _Kushtet teknike mbi kryqëzimin e kabllove nëntokësore
Pjesa 10_Kushtet teknike të ndërtimit të rrjetit të tensionit të ulët
Pjesa 11_Kushtet teknike mbi shtyllat centrifugale prej betoni
Pjesa 12_Kushtet teknike për realizimin e instalimeve elektrike
Pjesa 13_Akt teknik tip për marrjen në dorëzim të kabinës elektrike

Të gjitha kërkesat dhe kushtet teknike të mësipërme mund të shkarkohen nëpërmjet faqes në internet të kompanisë www.cez.al

Aplikim per Lidhje te Re

Serial

Seksioni 1 - Detajet e Aplikantit

Aplikanti eshte	Konsumator ☐	Burim Gjenerimi ☐

Aplikanti eshte Konsumator	Familjar ☐	Jo-familjar ☐
	Buxhetor ☐	Jo-buxhetor ☐

Emer		Mbiemer		Atesia	
Nr. Identifikimi		Karte Votimi		NIPT	
Qyteti/Fshati:		Komuna		Qarku	
Rruga:		Kodi Institucional		Tel:	

Sektioni 2 - Perfaqesuesi i aplikantit (nese ka)

Emer		Mbiemer		Tel:	
Nr. Identifikimi		Qyteti		Fshati	

Seksioni 3 - Detajet e Objektit

Qyteti/Fshati:		Komuna		Qarku	
Rruga:				Tel:	

Seksioni 4 - Të dhëna mbi objektin

A keni leje ndertimi per objektin (banese/industri/etc) qe keni ndertuar?	Po ☐	Jo ☐
A keni dokument pronesie mbi objektin qe kerkon lidhje me energji?	Po ☐	Jo ☐
A keni marreveshje qerraje per objektin qe kerkon lidhje me energji?	Po ☐	Jo ☐

Seksioni 5 - Lloji i Furnizimit

☐ Lidhje e Re	☐ Shtese fuqie	☐ Furnizim i përkohshëm
☐ Alternim shërbimesh	☐ Transferim shkalle tensioni	☐ Transferim vend-lidhjeje

Seksioni 6 - Lloji i biznesit

Apartament ☐	Shtepi ☐	Kompleks banimi ☐	Industri ☐	Bujqesi ☐	
Sherbime ☐	Furre buke ☐	Miell ☐	Ndertim ☐	Tjera ☐	

Seksioni 7 - Lloji i tensionit te lidhjes ne rrjet

0.4 kV ☐	6 kV ☐	10 kV ☐	20 kV ☐	35 kV ☐	
	Nje burim furnizimi? ☐		Dy burime furnizimi ☐		

Seksioni 8 - Lloji i rregjimit

Kerkoni nje furnizim nje apo tre fazor?	☐ fazor	☐ fazor

Seksioni 9 - Detaje të ngarkesës elektrike

Fuqia max. e instaluar (kW)		Fuqia max. e kërkuar (kW)	
Fuqia e motorit me te madh(kW)		Saldatrice/Furre induktive(kVA)	

A do te instaloni burrim paralel alternativ (Diezel Gjenerator. etc)? ☐ Po ☐ Jo

Seksioni 10 - Detaje të burimeve te gjenerimit

Fuqia max. e plote (kVA)		Tensioni Nominal (kV)	
Fuqia max. Active (kW)		Fuqia max. Reactive (kVAr)	

Seksioni 11 - Deklarimi

1. Unë konfirmoj që i kam plotësuar të gjitha seksionet që kanë të bëjnë me aplikimin tim për lidhje të re. Dokumentat e kerkuara jane paraqitur bashkangjitur ne forme origjinale ose kopje te noterizuara.
2. Une deklaroj se kam instaluar te gjitha pajisjet mbrojtese nga lidhja e shkurter, ato te mbrojtjes nga lidhja me token si edhe pajisjet e mbrojtjes nga mbitensionet per cdo konsumator qe do te furnizohet me energji elektrike nga kjo lidhje e re.
3. Une deklaroj se kam realizuar sistemin e tokezimit te objektit dhe konsumatoreve te tjere qe furnizohen me energji elektrike nga kjo lidhje, ne perputhje me kushtet teknike dhe normat ne fuqi.
4. Une deklaroj gjithashtu se te gjitha instalimet elektrike ne te gjithe objektin qe une kerkoj te furnizohet me energji elektrike jane kryer, inspektuar dhe provuar nga nje kontraktor i pajisur me license per projektimin dhe instalimin e pajisjeve elektrike ne perputhje me rregullat dhe kushtet teknike ne fuqi.
5. Si perfundim, une e marr persiper te cliroj nga cdo lloj pergjegjesie Cez Shperndarje per cdo lloj detyrimi qe lidhet me demtime te cdo lloj te rrjetit shperndares te shkaktuara nga instalimeve te brendshme te pajisjeve elektrike ne objektin qe kerkoj lidhjen me energji elektrike.

Emer	Mbiemer	Firma	Data

Date: [ ]

Subjekti: **PRANIM I PROPOZIMIT PER LIDHJEN E RE NE RRJETIN E CEZ SHPERNDARJE**

Aplikanti: [ ]
Objekti: [ ]
Adresa: [ ]
Numri i Aplikimit: [ ]

Unë pranoj Propozimin Tuaj per Lidhjen e re të datës [ ], No.Prot [ ]sebashku me tarifat respektive per realizimin e saj.

Unë jam dakord të paguaj shumën prej [ ]Lekë, duke përfshirë TVSH në shumën prej [ ]Lekë dhe në total [ ]Lekë .

E pranoj dhe jam dakord me " Marrëveshjen e Lidhjes së Re".

Pranoj dhe jam dakord se punimet duhet të kryhen në përputhje me Standartet dhe Specifikimet Teknike të CEZ Shpërndarje sh.a, një kopje të të cilave e kam lexuar si Aneks te "Marreveshjes per Lidhjen e re".

Unë do të projektoj dhe ndërtoj Pikën e Transformimit dhe menyren e lidhjes me rrjetin shperndares, si edhe do të instaloj të gjitha pajisjet me shpenzimet e mia ne perputhje me kerkesat teknike te CEZ Shperndarje.

Do t'i kërkoj CEZ Shperndarje të inspektojë dhe miratojë punimet ndertimore dhe instalimet e kryera, ashtu siç parashikohet edhe në "Marrëveshjen e Lidhjes së Re".

Do të paraqese ne kohe kërkesat për të testuar/lidhur me rrjetin dhe, nëse ndonjë test nuk rezulton i saktë, atëherë Une do të kryej të gjitha riparimet e defekteve.

Me Respekt

Aplikanti

[ ]

[ ]

VENDIM
Nr. 24, datë 2.3.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "PESHKU PICAR 1" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "PICARI 1"

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a"; 5 pika 1 germa "a" dhe nenit 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.3.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Peshku Picar 1" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Peshku Picar 1" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Peshku Picar 1" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Picar 1" me fuqi 0.2 MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 25, datë 2.3.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HYDRO SALILLARI" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "VERTOP"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "a", dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.3.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hydro Salillari" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hydro Salillari" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 të nenit 9 (pika e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes) është në proces.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hydro Salillari" sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Vertop" me fuqi 1.52 MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 26, datë 2.3.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HYDRO SALILLARI" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "g", nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.3.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Hydro Salillari" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hydro Salillari" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hydro Salillari" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 324, datë 16.2.2012, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Artur Vasil Madhi.

KËRKESË

Kërkuesi Ermal Hoxha, i biri i Lefterit dhe Bajames, i datëlindjes 29.9.1990, lindur dhe banues në Kraps, Fier, kërkon shpalljen të zhdukur të babait të tij, shtetasit Lefter Hoxha.

KËRKUES
Ermal Hoxha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 2.4.2012
Doli nga shtypi më 3.4.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë